

1. Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit

Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH) përfshijnë programet dhe projektet që aplikohen në përputhje me fushat prioritare të miratuara nga Këshilli i Politikës Shkencore dhe Zhvillimit Teknologjik (KPSHZHT) për një periudhë të caktuar kohe (trevjeçare ose më shumë sipas interesave të vendit). Programet Kombëtare implementohen nëpërmjet projekteve që realizojnë objektivat e programit, ku bashkëpunohet me një ose më shumë Institucione apo grupe specialistësh. Secili Program Kombëtar është pajisur me dokumentacionin përkatës të hartuar nga një grup ekspertësh të fushave përkatëse me tituj e grada shkencore.

Për periudhën 2010 - 2012 janë shtatë Programe Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit:

1- Programi Kombëtar "Shkencat Sociale dhe Albanologjike"

Ky program përqëndrohet në disa nga fushat themelore të historisë, gjuhës, kulturës materiale e shpirtërore të popullit shqiptar, shprehjes së identitetit të tij, traditat historike, sociale e kulturore, folklorin, etnografinë, vlerat sociale arkeologjike, letërsinë artistike, artet, aspekte të ndryshme të jetës ekonomike, politike, shoqërore e arsimore, vlerat shkencore, aspekte të jetës fetare, aspekte të jetës së shqiptarëve në diasporë, procese të reja urbane, si dhe probleme të rëndësishme social-psikologjike të periudhës së tranzicionit.

2- Programi Kombëtar "Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit (TIK)"

Përqëndrohet në fushat e veprimtarisë së mëposhtme:

- Fushat e veprimtarisë shkencore e zhvilluese
 - Kërkimi në fushën e TIK
 - Zhvillimi i aplikimeve të TIK
 - Mbështetja me infrastrukturë
- Fushat e veprimtarisë ekonomike, shoqërore e kulturore ku zbatohen rezultatet e Programit: edukimi, shëndeti, qeverisja, biznesi, siguria, energjia, mbrojtja e mjedisit, trashëgimia kulturore.

3- Programi Kombëtar "Bujqësia (Veterinaria, Zooteknika), Ushqimi dhe Bioteknologjitë"

Ky program realizohet në përputhje me prioritetet që përcaktohen në Strategjinë Sektoriale të Bujqësisë dhe Ushqimit 2007-2013, të cilat janë si më poshtë:

- Rritja e mbështetjes financiare për fermat, bizneset bujqësore dhe ato agropërpunuese

- Përmirësimi i menaxhimit, ujitja dhe kullimi i tokës bujqësore
- Përmirësimi i marketingut të produkteve bujqësore dhe atyre të përpunuara
- Rritja e nivelit dhe cilësisë së teknologjive, informacionit dhe njohurive të fermerëve dhe agropërpunuesve
- Rritja e cilësisë dhe sigurisë ushqimore të produkteve bujqësore dhe atyre të përpunuara

4- Programi Kombëtar “Uji dhe Energjia”

Ky program bazohet në programin e qeverisë për zhvillimin shkencor e atë ekonomik, si dhe direktivat Europiane për prioritetet e kërkim-zhvillimit, për dhënie e ndihmës në zgjidhjen e problemeve më emergjente të vendit siç janë energjia dhe uji.

Programi do të stimulojë kërkimin shkencor dhe teknologjik në vend, duke qenë edhe një mbështetje për forcimin e kërkimit shkencor në universitete dhe qendrat kërkimore të ngritura pranë tyre.

5- Programi Kombëtar “Biodiversiteti dhe Mjedisit”

Ky program bazohet në Strategjinë Kombëtare të Mjedisit 2008-2012 dhe Planit Kombëtar të Biodiversitetit. Në këto dokumente përfshihen planet konkrete të veprimtimit për ajrin, ujin, mbetjet e ngurta urbane, tokën, biodiversitetin, peisazhin, zonat e mbrojtura, përdorimin e energjive alternative, edukimin mjedisor dhe ndërgjegjësimin e publikut etj. Vëmendja përqëndrohet në ngritjen e rrjetit ekologjik Pan-Evropian, përfshirjen e parimeve të larmisë biologjike, ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e publikut, ruajtjen e peisazheve, ekosistemet bregdetare dhe detare, ligatinore dhe lumore, barishtore dhe bujqësore, pyjore dhe alpine, në llojet e rrezikuara dhe në 13 konventat ndërkombëtare dhe marrëveshjeve mjedisore, përfshirë dhe Konventën për Mbrojtjen e Biodiversitetit.

Çështjet mjedisore me përparësi në program janë:

- pyjet dhe shkorretat e pellgjeve ujëmbledhës;
- gjeomorfologjia e pellgjeve ujëmbledhës;
- eutrofikimi i ujërave;
- fauna (shpendët dhe gjitarët);
- bimë industriale mjekësore;
- trajtim dhe shfrytëzim mbetjesh dhe biomase;
- ekoteknologjitë;
- rreziqet natyrore

6- Programi Kombëtar "Shëndeti"

Duke patur parasysh se zhvillimi i shëndëtesisë ka qënë gjithmonë i varur nga nxitja dhe zhvillimi i kërkimit shkencor, studimeve me cilësi të lartë dhe mbështetjes së orientimit të kërkimit drejt praktikës, fushat prioritare të kërkimit shkencor në shëndetësi do të jenë;

- Parandalimi i sëmundjeve dhe faktorët e riskut
- Shëndetit mendor
- Sëmundjet kronike me rëndësi të veçantë
- Sëmundjet infektive
- Vlerësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetsore

7- Programi Kombëtar 'Materialet'

Ky program përfshin fushat e veprimtarisë shkencore dhe zhvillimore si më poshtë:

- Metodrat dhe teknikat e avancuara për karakterizimin, testimin, investigimin dhe vlerësimin e materialeve, produkteve apo objekteve;
- Infrastruktura dhe menaxhimi i njësive të specializuara për zbatimin e metodave dhe teknikave të mësipërme.
- Metoda, Standarde dhe Kode bashkëkohore të përzgjedhjes e shfrytëzimit racional të materialeve, bazat e të dhënave dhe softet në fushën e materialeve.